



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202101547/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë në Vlorë.*

**Drejtuar:** **Drejtuesi i Parë Gentian BERBERI**  
**Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë**

**VLORË**

**Kryekomisar Agim BASHA**  
**Shef i Komisarariatit të Policisë**

**VLORË**

**Për dijëni:** **Drejtues Madhor Gledis NANO**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit**

**TIRANË**

*Të nderuar zotërinj,*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe në nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në mjediset e privimit të lirisë së personit, ambienti i shoqërimit dhe ambienti i sigurisë, në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë në Vlorë.

Inspektimi u krye në datën 17.11.2021, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit drejtohej nga znj. Ermonela Xhafa, Komisionere e Mekanizmit Kombëtar dhe përbëhej nga z. Besnik Deda, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe z. Hazbi Selita me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938 datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde të punës “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm të kryer në datë 03.12.2020<sup>1</sup>.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, që do ti gjeni në vijim.

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në mjediset e policisë së shtetit, ku mbahen e trajtohen shtetasit që ju privohet liria, grupi i inspektimit, në mungesë (për arsye pune) të drejtuesve të këtij institucioni, u takua me shefin e rendit në Komisariatin e Policisë në Vlorë, z.Kristaq Pata.

Gjatë takimit, grupi i inspektimit u informua mbi gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë të komisarariatit, respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e këtij komisaritati, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e vitit 2020.

Grupi i punës, inspektoi ambientet e shoqërimit dhe ato të sigurisë të komisarariatit, zyrat e punonjësve të policisë, u njoh me dokumentacionin ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar sipas kërkesave të përcaktuara në procedurat standarde për këtë qëllim, si dhe administroi kopje të tyre.

Theksojmë se, drejtuesit e policisë në Komisariatin e Policisë Vlorë, si dhe punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit që zhvilloi grupi inspektues në mjedisin e këtij komisaritati.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm rezultoi se:

1. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, **për ndërtimin e ambientit të ri të sigurisë** në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë Vlorë, sipas procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

---

<sup>1</sup> Shkresë nr.K4/I51-2 prot., datë 29.12.2020 dërgohet “Rekomandim për inspektimin e kryer në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë Vlorë”.

2. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për **ndërtimin e ambientit të shoqërimit**, të plotësuar me dhoma shoqërimi të ndara më vete për personat e rritur, për gratë dhe për të miturit sipas procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.
3. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin në ambientet e sigurisë të **dhomës për marrjen në pyetje/intervistimin** e personave të ndaluar/arrestuar.
4. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin e **dhomës së mjekut për kryerjen e vizitave mjeksore** brenda në ambientin e sigurisë, të pajisur me orenditë e nevojshme.

Ndërkohë, nga inspektimi u evidentua gjithashtu se:

1. Ishte plotësuar rekomandimi, për **zëvendësimin e posterave të vjetër me postera të rinj**, ku pasqyrohen të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë.
2. Ishte plotësuar rekomandimi, për **lyerjen dhe dizifektimin e dhomave në ambientin e sigurisë**, për ruajtjen e shëndetit të personave të ndaluar/ arrestuar dhe parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19.

Nga verifikimi i këtyre rekomandimeve dhe sipas informacionit në DVP Vlorë dhe Komisariatin e Policisë, rezultoi se, shkak u kryesor i moszbatimit të tyre kishte të bënte me mungesën e fondeve buxhetore të planifikuara për investime, pavarësisht se projekti për rikonstrukcionin e godinave të Drejtorisë dhe Komisarariatit të Policisë Vlorë dhe ndërtimin e bllokut të dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë, është miratuar që në vitin 2019.

Grupi i inspektimit kontrolloi dhe zbatimin e masave për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19 në ambientet e këtij institucioni, sipas protokollit shëndetësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kryesisht në zyrat e punës, në dhomat e shoqërimit, si dhe në mjedisin ku mbahen dhe qëndrojnë personat e ndaluar/arrestuar.

Punonjësit e policisë ishin të pajisur dhe lëviznin në ambientet e punës me maska mbrojtëse, si dhe tregonin kujdes për ruajtjen e distancimit fizik dhe social. Në vende të aksesueshme ishin vendosur dizifektantë për pastrimin e duarve. Sipas një grafiku të miratuar në çdo 3 muaj, vijonte dizifektimi i të gjitha ambienteve të brendshme të komisarariatit për parandalimin e përhapjes të këtij virusi infektiv, nga një subjekt privat i kontraktuar nga DVP Vlorë, si dhe ndihmuar nga Bashkia Vlorë.

Në hyrje të institucionit, si dhe në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, ishin afishuar postera me rregullat e përgjithshme për parandalimin e pandemisë.

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisariatin e Policisë Vlorë ambienti i shoqërimit **nuk** ishte ndërtuar sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938 datë 24.07.2019, për miratimin e

procedurës standarde të punës “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”<sup>2</sup>, ku përcaktohet shprehimisht se “Mjediset/ambientet (për mbajtjen e personave të shoqëruar) të jenë të ndara më vehte për persona të rritur, femra dhe të mitur”.<sup>3</sup>

Në katin e parë së godinës të komisariatit të policisë ndodhej 1 (një) dhomë shoqërimi, e cila shërbente për mbajtjen dhe qëndrimin e personave të shoqëruar të rritur. Kjo dhomë ishte e ndarë në dy ambiente dhe ishte e pajisur me karrige dhe tavolinë. Përmasat e dhomës ishin 4mx3 m dhe kapaciteti i saj ishte për qëndrimin ulur deri në 5 persona.

Dhoma kishte një dritare që mundësonte ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe kishte ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dritarja ishte e siguruar me skarë hekuri me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga mjediset e komisariatit.

Dhoma e shoqërimit nuk kishte (brenda ose ngjitur me të) tualet të ndarë më vehte për personat meshkuj nga tualeti për femra, por për nevojat e tyre personale këta persona shoqëroheshin në tualetin e komisariatit që ndodhej në katin e parë të godinës.

Ajo ishte e pastër nga ana higjieno sanitare, por kishte nevojë për lyerje dhe ndihej era e lagështirës. Në këtë dhomë nuk kishte mjete apo pajisje që ekspozonin dhunë psikologjike ndaj personave që qëndronin në këtë ambient.

Në mungesë të ambienteve të veçanta për intervistimin, marrja në pyetje e personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës së punonjësve të policisë. Nga inspektimi në zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk u konstatuan gjithashtu sende apo pajisje që të ekspozonin dhunë psikologjike ndaj personave të shoqëruar kur merreshin në pyetje prej tyre.

Personat e shoqëruar si gra dhe të mitur, qëndronin në një mjedis të krijuar më vehte, “Njësia për mbrojtjen e grave viktime të dhunës në familje dhe kundër trafikimit të qënieve njerëzore”, e cila përdorej edhe për të miturit e shoqëruar. Ky mjedis përbëhej nga dy dhoma, një dhomë për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar dhe një dhomë që përdorej për intervistimin e grave dhe të të miturve, nga punonjës të policisë të trajnuar për këtë qëllim.

Dhomat ishin të kompletuara me orënditë dhe pajisjet e nevojshme për qëndrimin ulur të personave, si dhe me kushte komode pune për intervistimin e tyre nga punonjësit e policisë. Ato kishin sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme, si dhe me dritare që mundësonin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Këto dhoma ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno sanitare.

Mjedisi ku ndodhej “Njësia për mbrojtjen e grave viktime të dhunës në familje dhe kundër trafikimit të qënieve njerëzore”, ndodhej në ambient më vehte nga dhoma e shoqërimit për të rritur. Këto dhoma ishin të ndara nga njëra tjetra dhe nuk krijonin një ambient shoqërimi

---

<sup>2</sup> Kreu i VII “Zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar” pika 2, 3, 4 dhe 5 i procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”.

<sup>3</sup> Kreu VII, pika 4/b e procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”

unik, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurën standarde të shoqërimit në mjediset e policisë. Por, në çdo rast nga pikpamja e mbrojtjes të shoqëruarve, Avokati i Popullit nuk ka kundërshtim në qëndrimin e grave në këtë ambient.

“Njësia për luftën kundër dhunës në familje dhe trafikimit të qënieve njerëzore” në DVP Vlorë, kishte një bashkëpunim të mirë me Qendrën “Vatra”, e cila trajton dhe strehon gratë e vajzat të cilat janë të evidentuara si të tilla gjatë procesit të hetimit nga punonjësit e policisë, ose janë të rrezikuara për trafikim, me qëllim ri-integrimit të tyre në shoqëri.

Sipas informacionit të shefit të rendit, DVP Vlorë kishte miratuar një projekt për ndërtimin e 3(tre) dhomave të shoqërimit dhe një dhome për takimin me avokatë mbrojtës, i cili do të zbatohet në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë Vlorë. Ky ambient do të ndërtohet në katin e parë të godinës ku ndodhen dhomat e sigurisë të këtij komisariati, duke krijuar një bllok më vehte për dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë. Projekti ka nisur punimet (sipas konfirmimit të shefit të rendit në Komisarlatin e Policisë Vlorë) dhe do të përfundojë zbatimin e tij në fundin e muajit Dhjetor 2021.

Korridori dhe ambienti i shoqërimit nuk monitorohej nga sistemi i veçantë i kamerave, ndonëse korridoret e brendshme të komisarlatit dhe ambienti jashtë tij, monitoroheshin nga kamera. Sistemi i kamerave administrohej nga DVP Vlorë dhe pamjet ruheshin deri në 15 ditë.

Në ambientet brenda dhe jashtë dhomave të shoqërimit, ishin të afishuara karta me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë së shtetit.

Në momentin e inspektimit, nuk ndodhej asnjë person i shoqëruar në këto ambiente. Nga verifikimi i regjistrimit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar, për periudhën Janar–Nëntor 2021, ishin shoqëruar në këto mjedise gjithsej 2020 persona, prej të cilëve 6 ishin gra dhe 13 të mitur.

Në mjediset e shoqërimit, grupi i inspektimit nuk konstatoi sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Ambienti i sigurisë në Komisarlatin e Policisë Vlorë, **nuk** plotëson kushtet dhe standartet për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohen në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Ky ambient ndodhej në katin e parë të një prej godinave brenda territorit të Komisarlatit të Policisë Vlorë. Ai përbëhej nga 4(katër) dhoma sigurie, nga të cilat 2(dy) dhoma për persona e rritur të plotësuar me katër krevatë, 1(një) dhomë për gratë me dy krevatë dhe 1(një)

dhomë për të mitur me një krevat. Kapaciteti fizik i dhomave të sigurisë ishte për mbajtjen dhe akomodimin deri në 7 persona.

Nisur nga fakti se, DVP Vlorë mbulon një qark të rëndësishëm nga pikëpamja e numrit të lartë të popullsisë, fluksit të njerëzve që frekuentojnë këtë zonë gjatë gjithë vitit, numrit në rritje të çështjeve penale të evidentuara vitet e fundit, si dhe duke ditur se në këto dhoma sigurohen personat e ndaluar dhe të arrestuar nga punonjësit e komisariateve të policisë Vlorë, Himarë dhe stacionet e policisë Orikum dhe Selenicë, **numri i dhomave të sigurisë dhe kapaciteti i tyre, është shumë i ulët.** Ndaj në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, është e domosdoshme rritja e numrit dhe kapaciteteve mbajtëse të dhomave të sigurisë të këtij komisariati.

Në momentin e inspektimit, grupi i monitorimit konstatoi se në dhomat e sigurisë ndodheshin 9 (nëntë) persona në cilësinë e të arrestuarve, nga të cilët 7 ishin persona të rritur dhe 2 ishin të mitur. Në bazë të të dhënave, **ndodheshin 2 persona mbi kapacitetin** e këtyre dhomave. Këta persona flinin në dyshekë të vendosur në dyshe-menë prej dërrase.

Ndërsa, nga verifikimi i regjistrit me të dhënat e personave të ndaluar/arrestuar, rezultoi se për periudhën Janar – Nëntor 2021, në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Vlorë, ishin mbajtur dhe akomoduar 436 persona në cilësinë e personit të arrestuar apo të ndaluar. Nga këta, 417 ishin persona në moshë të rritur, 6 gra dhe 13 të mitur.

Nga verifikimi i regjistrit, rezultoi se në dhomat e sigurisë, kishte patur mbipopullime dhe në dy raste të tjera për periudhën e ushtrimit të kontrollit nga grupi i inspektimit. Çështja e mbipopullimit shton edhe më shumë rrezikun e përhapjes të virusit COVID-19.

Referuar normave dhe parametrave që duhet të plotësojnë dhomat e sigurisë, sipërfaqja dhe hapësira e dhomave të sigurisë në këtë komisarariat, ishte e bollshme për të përballuar kapacitetin prej 7 personash. Dritaret e dhomave ishin me përmasa të vogla dhe **nuk** mundësonin ajrim dhe ndriçim natyral të mjaftueshëm. Në këtë ambient kishte ndriçim artificial që sigurohej nga rrjeti elektrik dhe në rast ndërprerje të energjisë elektrike, kishte burim rezervë për furnizimin me energji elektrike me gjenerator.

Dhomat e sigurisë ishin të pastra nga ana higjieno sanitare, por kishin nevojë për dizifektim 3D të vazhdueshëm pasi ndihej era e mykut, për shkak të hapsirave të vogla dhe amortizimit të godinës. Ato ishin të kompletuara me krevatë dhe materiale për fjetje si dyshek, batanie dhe jastëk për 7(shtatë) persona. Materialet e fjetjes për personat e ndaluar/arrestuar mbaheshin në një magazinë dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Në ambientin e sigurisë kishte tre tualete, nga të cilat dy ishin brenda dhomave (dhoma për gra dhe dhoma për të mitur) dhe një tualet i përbashkët që ndodhej në korridor bashkë me ambientin e dushit me ujë të ngrohtë për larjen e trupit. Në tualete kishte ujë të rrjedhshëm për mbajtjen e higjienës personale, të dhomave dhe ambienteve të përbashkëta.

Komisariati i Policisë Vlorë **nuk** kishte sistem qëndror për ngrohje/ftohje, por në dhomat e sigurisë ngrohja sigurohej me paisje elektrike, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Ambienti i sigurisë përveç dhomave të sigurisë, kishte **vetëm 1(një) dhomë** e cila përdorej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë për mbajtjen e dokumentacionit, si dhe për marrjen në pyetje/intervistimin e të ndaluarve/arrestuarve nga OPGJ/prokurorët e çështjes, apo për takime të këtyre personave me avokatët mbrojtës. Kjo dhomë kishte vetëm një tavolinë pune, një karrige dhe disa rafta për mbajtjen e dokumentacionit, si dhe shërbente njëkohësisht si magazinë për mbajtjen e materialeve që i nevojiteshin përgjegjësit të dhomave të sigurisë për furnizimin e personave të ndaluar/arrestuar me mjete apo materiale për jetesë normale.

Funksionimi në këtë mënyrë i dhomës për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e organit të akuzës është në kundërshtim me kriteret e sigurisë të parashikuara në procedurën standarde për këtë qëllim, ku thuhet se : *“Brenda sistemit të dhomave të sigurisë funksionon një dhomë e veçantë për zhvillimin e procesit të marrjes në pyetje...në këtë dhomë vendosen tavolina pune e karrige për të qëndruar ulur e punuar përfaqësuesit e organit të akuzës (oficer i policisë gjyqësore apo prokurori), avokati mbrojtës /përfaqësuesi ligjor, si dhe i ndaluari/arrestuari”*.

Gjithashtu, edhe dhoma për kryerjen e vizitave mjeksore të personave të ndaluar/arrestuar nga mjeku, ndodhej në katin e 3 të kësaj godine dhe jo brenda ambientit të sigurisë, sikurse përcaktohet në procedurën standarde ku thuhet shprehimisht se: *“Brenda sistemit të dhomave të sigurisë, krijohet dhe funksionon një mjedis i veçantë i cili shërben si dhomë për kryerjen e vizitave mjeksore nga personeli përkatës”*.

Ndërtimi në këtë mënyrë i të gjithë elementëve që përbëjnë ambientin e sigurisë në Komisaratin e Policisë Vlorë, siç janë dhoma për marrjen në pyetje dhe dhoma për kryerjen e vizitave mjeksore, janë në kundërshtim, sikurse e theksuam më lartë, me kriteret e miratuara në procedurën standarde për këtë qëllim<sup>4</sup>, por edhe me parimet bazë për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar të përcaktuara në Konventën “Për parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore e degraduese”<sup>5</sup>.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ishte instaluar një telefon fiks, i cili shërbente në rastet emergjente për njoftimin e zyrës së informacionit nga punonjësit e policisë që shërbenin në këtë ambient. Ndërsa në dhoma **mungonte** butoni me zile/sinjali në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevojë.

---

<sup>4</sup> Kreu VII, pika 7 dhe 8 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

<sup>5</sup> <https://rm.coe.int/16806dbac6> dhe <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/konventa%20kunder%20tortures%20dhe%20trajttimeve%20a%20denimeve%20te%20tjera%20mizore%20cnjerezore%20ose%20poshteruese%20-%20Shqip.pdf>

Në pjesën e jashtme dhe në korridorin e ambientit të sigurisë, ishin instaluar kamera për mbajtjen në vëzhgim të këtij ambienti. Ndërkohë që në dhomën e cila përdorej për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar, **mungonte** sistemi i monitorimit me kamera audio-vizive. Kjo, përbën shkelje të kriterëve për ndërtimin e dhomës për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të arrestuar/ndaluar, njëkohësisht dhe shkeljen e të drejtave që gëzojnë këta persona, gjatë procesit të intervistimit të tyre.

Vendosja e pajisjeve të sigurisë (sisteme kamerash audio–vizive) në këto ambiente është një garanci për parandalimin e veprimeve të dhunshme që mund të kryhen nga punonjësit e policisë gjatë marrjes në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar apo kundërveprimeve të këtyre personave ndaj punonjësve të policisë. Në këto kushte, vendosja e këtyre pajisjeve kryhet për monitorimin e ambienteve, veprimeve procedurale hetimore të punonjësve të policisë me të arrestuarit/ndaluarit dhe çdo aktivitet tjetër në këto ambiente, si dhe në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar<sup>6</sup>.

Në rastet, kur personat e ndaluar/arrestuar ishin shtetas të huaj, zbatohet menjëherë procedura e njoftimit të strukturave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe përfaqësisë diplomatike të vendit të tyre, si dhe pajiseshin me kartën e të drejtave në gjuhën amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë, nëpërmjet avokatit apo një përkthyesi.

Në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë ndodhej karta e të drejtave të shtetasve që ju privohet liria në mjediset e policisë, përkthyer në 13 gjuhë të huaja më kryesore.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në Komisariatin e Policisë Vlorë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1”, konform procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

Të gjithë personat e shoqëruar, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, regjistri ishte plotësuar sipas rubrikave dhe ishte i sekretuar. Koha e qëndrimit të shtetasve në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë, por jo më shumë se 10 orë në raste të veçanta. Në rastet kur akti/veprimi i shoqërimit kryhet nga oficeri/agjenti i policisë gjyqësore për personin nën hetim, në bazë të nenit 295, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, afati kohor i mbajtjes së personit është jo më tepër se 12 orë.

---

<sup>6</sup> *Kreu XIV, pika 6.1 dhe 6.2/b të procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*



Në zyrën e informacionit të Komisarariatit, ishte hapur një regjistër më vehte për evidentimin e të dhënave të personave të mitur, në bazë dhe rekomandimit të Avokatit të Popullit për këtë qëllim<sup>7</sup>. Për vitin 2021 ishin evidentuar të dhënat për 13 persona të mitur.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit nga punonjësit e policisë të këtij komisarati evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Grupi i inspektimit **verifikoi regjistrat** ku evidentohen rastet e shoqërimit dhe të arrestimeve/ndalimeve të kryera nga punonjësit e komisarateve të policisë në varësi të DVP Vlorë dhe konstatoi se, zbatohet rekomandimi i Avokatit të Popullit për ndryshimin e praktikës së viteteve të kaluara lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit apo ndalimit orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra orën kur personit i është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës nga oficeri i policisë gjyqësore.

### **Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.**

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisaratin e Policisë Vlorë, nuk kishte asnjë person në cilësinë e të shoqëruarit, ndërsa në dhomat e sigurisë ndodheshin 9(nëntë) persona në cilësinë e të arrestuarve.

Nga inspektimi dhe nga verifikimi i regjistrave për evidentimin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar, rezultoi se, në momentin e inspektimit dhe në dy raste të tjera gjatë periudhës Janar-Nëntor 2021, u konstatuan mbipopullime në dhomat ku mbahen dhe trajtohen këta shtetas. Nisur nga fakti se, këta persona kur janë mbi kapacitetin që duhet të mbahen në dhomat e sigurisë, detyrohen të flenë me dyshekë në dysheme, përbën një trajtim jo dinjitoz të këtyre shtetasve.

Grupi i inspektimit intervistoi personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë, duke u ndalur veçanërisht te dy personat e mitur. Nga intervistimi rezultoi se ata ishin të pajisur me kopjen e dokumenteve që duhet të mbahet prej tyre si, urdher ndalimi/arrestimi, procesverbali për dorëzimin e sendeve personale, si dhe letra me të drejtat e këtyre personave. Ata ngritën shqetësimin se dhomat ishin të vogla për numrin e personave që ndodheshin aty, ndëkohë që nuk paraqitën asnjë ankesë për keqtrajtime nga punonjësit e policisë gjatë marrjes në pyetje, si dhe për punonjësit që kryejnë shërbim në ambientin e sigurisë.

Nga intervistimi i të miturve, ata deklaruan se ishin marrë në pyetje nga punonjësit e policisë në prezencë të familjarëve, avokatit mbrojtës dhe të psikologut. Ata ishin akomoduar në dhomë të veçantë nga personat e rritur dhe nuk paraqitën asnjë shqetësim për keqtrajtim.

---

<sup>7</sup> Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019 “Për garantimin e të drejtave të miturve të privuar nga liria në zbatim të legjislacionit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur”.

Gjithashtu, edhe nga **verifikimi i librit të ankesave dhe kërkesave**, për periudhën e inspektimit ishin evidentuar 17 kërkesa për vitin 2021, nga të cilat nuk kishte asnjë ankesë apo pretendim për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike nga punonjësit e policisë. Kërkesat në libër kishin për objekt njoftimin e familjarëve apo kërkesë për avokat mbrojtës. Kjo praktikë është për tu vlerësuar, pasi tregon se kërkesë/ankesat e të shoqëruarve dhe të ndaluar/arrestuarve depozitohen në regjistër nga punonjësit e policisë dhe funksionon procedura e trajtimit e zgjedhjes së tyre.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë, ndërsa të miturit deri në katër vakte, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë. Ushqimi shërbehej me catering nga një subjekt privat, në bazë të kontratës së lidhur midis DVP Vlorë dhe këtij subjekti.

Personat në kohën që ndodheshin në ambientin e sigurisë, gëzonin të drejtën për të kryer ritet fetare sipas besimeve të tyre, si dhe të adresojnë çdo ankesë apo kërkesë që ata shikojnë të arsyeshme për nevojat e tyre. Ankesat/kërkesat shënohen në regjistër të veçantë nga personeli i shërbimit në ambientin e sigurisë dhe njoftonin menjëherë eprorët për zgjidhjen e tyre.

Gjithashtu, personat e ndaluar/arrestuar ishin furnizuar me detergjente, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqirë e mjete të tjera nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, si kusht për mbajtjen pastër të higjienës personale, ambientit të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

Në hyrje të ambientit të sigurisë dhe në korridorin e tij, ishin afishuar posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe numrat e kontaktit të Avokatit të Popullit dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit në rast nevojë për parashtrimin e ndonjë ankese.

### **Ambientet e intervistimit**

Nga inspektimi i ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë në Komisaratin e Policisë Vlorë, rezultoi se mungonte dhoma e marrjes në pyetje/intervistimit më vehte, si për personat e shoqëruar dhe për personat e ndaluar/arrestuar, kur ata ndodhen për arsye shoqërimi apo si të dyshuar për vepra penale, në mjediset e këtij komisarati.

Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të kalonin nga ambienti i shoqërimit për në ambientin e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Këto zyra nuk plotësonin kushtet dhe kriteret e nevojshme që duhet të jenë të pajisura me orëditë e nevojshme dhe të monitoruara nga sistemi i kamerave audio-vizive.

Avokati i Popullit, bazuar në standardet ndërkombëtare e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të

shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre<sup>8</sup>.

Gjatë inspektimit u vizituan zyrat e punonjësve të policisë, që kryenin veprime procedurale me shtetasit e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar dhe nuk u gjetën paisje prania e të cilave ekspozon dhunë tek personat në kohën e intervistimit të tyre.

Në lidhje me investimin e parashikuar që në vitin 2019 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për rikonstruksionin e godinave të Drejtorisë dhe Komisarariatit të Policisë Vlorë, grupi i inspektimit konstatoi se, ende nuk ishin planifikuar fondet buxhetore për zbatimin e këtij projekti. Në këto kushte, DVP Vlorë ishte duke përshtatur një projekt të pjesshëm, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit dhe dhomës për marrjen në pyetje të personave që shoqërohen në mjediset e këtij komisariati, në bashkëpunim me donator privat, projekt i cili parashikohej të përfundonte brenda fundit të vitit 2021.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në korridorin dhe ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të Komisarariatit të Policisë Vlorë, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në mjediset e Policisë së Shtetit.

Grupi i inspektimit, verifikoi fashikullin e dokumenteve që pajisen personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, që në momentin e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë. Nga verifikimi u evidentua se, kopja e kartës me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, jepej nga punonjësit e policisë që në **momentin e hyrjes** në dhomat e shoqërimit, pra kohën kur ju privohej liria. Kjo është një praktikë e lavdërueshme dhe në vlerësimin e Avokatit të Popullit, ajo garanton për të shoqëruarit dhe të ndaluarit/arrestuarit një njohje më të mirë të të drejtave të tyre e shmang abuzimet eventuale.

Për personat e ndaluar apo të arrestuar, karta e të drejtave ju jepej edhe nga oficeri i policisë gjyqësore, bashkë me setin e dokumenteve (urdhëri për ndalimin/arrestimin në flagrancë të personit, procesverbali i dorëzimit të sendeve personale dhe karta me të drejtat), në momentin e komunikimit të masës së arrestit dhe kalimin e tyre për në dhomat e sigurisë.

Sipas informacionit, punonjësit e policisë u bënë të ditur personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, të drejtën për të patur avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje apo intervistimit të tyre.

---

<sup>8</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkëse të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

Personat që kërkonin mbrojtjen me avokat iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me avokatët mbrojtës në bazë të listës së afishuar në ambientin e sigurisë. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit, nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht të caktuar nga prokurori i çështjes, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, ose të zgjedhur nga familjarët e tyre, si dhe të psikologut. Psikologu ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë. Takimet me avokatët mbrojtës, kryheshin në dhomën e improvizuar në ambientin e sigurisë, sa herë që kërkohej nga personat e ndaluar/arrestuar.

Vizita mjekësore me personat e ndaluar/arrestuar, e parashikuar në procedurat standarde brenda 12 orëve, kryhej rregullisht nga mjeku në dhomën e tij (kati 3), i cili ishte në organikë të DVP Vlorë<sup>9</sup> dhe i punësuar me kohë të plotë. Vizitat mjekësore, rekomandimet për vizitë te mjeku specialist dhe mjekimet, regjistroheshin në librin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë të këtij komisariati. Në rastet e urgjencave, kur kërkohej ndërhyrje e mjekëve të specializuar, personat e sëmurë shoqëroheshin menjëherë për në Spitalin Rajonal Vlorë.

Sipas informacionit, vizitat mjekësore nga mjeku i DVP Vlorë, kryheshin dhe për personat e shoqëruar sa herë kërkohej nga ana e tyre, por në rast nevojë ata dërgoheshin edhe në Spitalin Rajonal të Vlorës.

Në ambientin e sigurisë, ishte e afishuar lista e personave të miratuar që kanë të drejtë të hyjnë në këtë ambient, lista e avokatëve mbrojtës, si dhe ishte afishuar numri i kontakti me zyrën e Avokatit të Popullit.

Gjithashtu në këtë komisarjat ishte hapur regjistri i kërkesë/ankesave të personave të arrestuar/ndaluar, por nga verifikimi i regjistrimit, nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë (për ushtrim dhune nga punonjësit e policisë) nga personat e shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar.

Në këtë komisarjat, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika 1/f të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të

---

<sup>9</sup> *Kreu V, pika 7/2 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

*drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, si dhe nenit 81, pika 2/b të ligjit 81/2020 ku përcaktohet se Mekanizmi Kombëtar ushtron këto kompetenca: “paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës”:*

### **REKOMANDOJMË :**

1. Të merren masat e nevojshme për sigurimin e fondeve buxhetore, **me qëllim ndërtimin e një ambienti të ri sigurie** në Drejtorinë/ Komisarriatin e Policisë Vlorë, me numër të shtuar të dhomave të sigurisë dhe kapacitete për të përballuar dinamikën e sigurimit të personave të ndaluar/arrestuar nga komisarriatet e policisë të Qarkut Vlorë, si dhe për të eliminuar rastet e mbipopullimeve në këto ambiente.
2. Të merren masat e nevojshme për të shpejtuar zbatimin e projektit për ndërtimin e ambientit të shoqërimit, sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, me ambiente të përshtatshme, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vehte për gratë, personat e rritur dhe për të mitur, i cili të jetë i monitoruar me sistemin e kamerave.
3. Të merren masa të menjëhershme për krijimin në ambientet e sigurisë të dhomës më vehte për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe instalimin e sistemit të kamerave audio-vizive.
4. Të merren masa të menjëhershme për krijimin e dhomës së mjekut për kryerjen e vizitave mjeksore në ambientin e sigurisë, të pajisur me orënditë e nevojshme.
5. Të merren masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të punonjësve të policisë që kryejnë detyra shërbimi në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë me ligjshmërinë, procedurat standarde dhe rekomandimet e CPT-së, për njohjen me këto akte dhe ngritjen e profesionalizmit të tyre, në zbatimin e standardeve më të mira për trajtimin e personave që shoqërohen në mjediset e Policisë së Shtetit.
6. Të vijojnë masat për dizifektimin e ambientit të sigurisë, eliminimin e erës së mykut dhe sigurimin e një higjiene të pastër në këto ambiente, për ruajtjen e shëndetit të personave të ndaluar/arrestuar, si dhe parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19.
7. Të mbahet në konsideratë detyrimi ligjor për depozitimin dhe trajtimin në kohë të kërkesë/ankesave të të shoqëruarve dhe të ndaluar/arrestuarve.
8. Të merren masa për sigurimin dhe vendosjen e kamerave në ambientin e ri të shoqërimit, për mbajtjen në vëzhgim dhe parandalimin e veprimeve të paligjshme të punonjësve të policisë me personat e shoqëruar.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brënda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFJA**